



**RREGULLORE
PËR GJYKIMIN DISIPLINOR
PROFESIONAL**

PJESA E PARË
PËRKUFIZIME DHE PARIME TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Baza ligjore dhe objekti

- 1.** Gjykimi Disiplinor Profesional dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional bazohen në Ligjin Nr. 40/2016“Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë dhe në Statutin e Urdhrit të Psikologut.
- 2.** Urdhri i Psikologut të Republikës së Shqipërisë (U.P.) ndërmerr veprime dhe bën gjykimin disiplinor profesional të anëtarit të tij në rastet kur:
 - a.** Kompetenca apo performanca profesionale e tij ka mangësi serioze,
 - b.** ka një akuzë për sjellje profesionale të padenjë,
 - c.** është dënuar nga organet e drejtësisë,
 - d.** për shkak të gjendjes së tij shëndetësore bëhet i paaftë dhe i papërgjegjshëm për të ushtruar profesionin,
 - e.** veprimet dhe sjellja e tij përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë dhe të legjislacionit në fuqi.

Neni 2

Qëllimi

- 1.** Hartimi dhe miratimi i kësaj rregullore ka si qëllim :
 - a.** të vendosë parimet dhe rregullat bazë për të siguruar një gjykim disiplinor objektiv, të drejtë dhe të paanshëm,
 - b.** të mbrojë anëtarin e Urdhrit nga një ndëshkim arbitrar dhe i pa merituar,
 - c.** nëpërmjet gjykimit disiplinor, bazuar në ankesat e mbërritura në Urdhër, të evidentojë dhe ndëshkojë shkeljet profesionale.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Gjykimi Disiplinor Profesional është i pavarur, i paanshëm, objektiv dhe i drejtë.
2. Të gjithë ankesat e mbërritura në Urdhrin e Psikologut, pa përjashtim, regjistrohen në regjistrin e ankesave dhe i nënshtrohen shqyrtimit në Komisionin e Etikës së Gjykimit Disiplinor Profesional, përveç atyre që janë haptazi të pabazuara apo që nuk plotësojnë elementet formale të pranueshmërisë.
3. Urdhri i Psikologut ndërmerr veprime disiplinore vetëm për çështje që i përkasin atributëve të tij të ligjshme, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit, duke i vlerësuar ato në kuadrin e akteve normative në fuqi.
4. Në rast të konflikteve midis dy psikologëve, Komisionin Etik Disiplinor Profesional bën të gjitha përpjekjet e mundshme që palët ta zgjidhin çështjen me pajtim.
5. Palët në gjykimin disiplinor kanë të drejtë të asistohen për mbrojtje ose të përfaqësohen në gjykim nga një avokat, i zgjedhur lirisht prej tyre. Kur Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional, apo Këshilli Kombëtar, e cilëson të domosdoshme praninë e palëve, atëherë ata janë të detyruar të jenë të pranishëm, pavarësisht pranisë së përfaqësuesit të tyre.

Neni 4

Pranimi i ankesave

1. Ankesa duhet të përmbajë identitetin e ankuesit, adresën, numrin e tij të kontaktit dhe shkeljen e pretenduar si të kryer nga psikologu, kundrejt të cilit drejtohet.
2. Ankesat anonime nuk pranohen për shqyrtim nga Komisioni i Etikës dhe Gjykimit Profesional, por mund të shërbejnë si indicie për të filluar procedimin kryesisht (*ex-officio*) me iniciativë të Presidentit të Urdhrit.
3. Të gjithë ankesat e mbërritura në Urdhrin e Psikologut i nënshtrohen verifikimit paraprak nga Zyra Juridike për të verifikuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në pikën 1) të këtij neni. Në rastet kur një apo disa nga të dhënat e kërkuara mungojnë, ankesa i kthehet ankuesit për plotësimin e të metave. Në këtë rast, çdo afat procedural fillon nga dita e dorëzimit të kërkesës së

plotësuar.

3.1 Afati i ankimit me pasojë mospranimin e tij është 6 muaj nga momenti i marrjes dijeni për shkeljen e pretenduar, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i kryerjes së saj.

4. Procedimi disiplinor mund të fillohet nga:

- a.** çdo anëtar i Urdhrit të Psikologut;
- b.** çdo individ, përfitues i një shërbimi në fushën e psikologjisë, për çështje në lidhje me shërbimin e ofruar;
- c.** çdo institucion publik ose privat;
- d.** Presidenti i Urdhrit të Psikologut, kryesisht (*ex-officio*);

Neni 5

Veprimi disiplinor për antarë të UP-së shtetas të huaj

1. Psikologët, shtetas të huaj, të cilët ushtrojnë profesionin brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen gjykimit disiplinor në përputhje me këtë Rregullore, si të gjithë anëtarët e Urdhrit të Psikologut me shtetësi shqiptare.
2. Në çdo rast kur prania e tyre është e nevojshme, procedimi kundrejt tyre duhet të zhvillohet me ndihmën e një përkthyesi zyrtar të gjuhës së tyre amtare ose, nëse kjo nuk është e mundur, të gjuhës të cilën ata deklarojnë se e njohin.
3. Masa disiplinore e vendosur ndaj tyre i njoftohet organit homolog të vendit përkatës.

PJESA E DYTË

KOMISIONI ETIK DHE MASAT DISIPLINORE

Neni 6

KOMISIONI I GJYKIMIT DISIPLINOR

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionon Komisioni Etik i Gjykimit Disiplinor Profesional, si

organizëm i gjykimit profesional. Ky komision përbëhet nga 5 anëtarë, të zgjedhur nga Këshilli Kombëtar.

2.Komisioni shqyrton ankesat e bëra në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë.

3.Këshilli Kombëtar gjykon të gjitha çështjet e ankimuara pas vendimit të marrë nga ana e Komisionit Etik të Gjykimit Disiplinor Profesional.

Neni 7

Përzgjedhja dhe emërimi i anëtarëve

(Ndryshuar me vendimin nr.4, datë 02.06.2023 të Asamblesë VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Për të garantuar që në çdo rast Komisioni Etik dhe i Gjykimit Profesional të gjykojë me 5 (pesë) anëtarë, Këshilli Kombëtar zgjedh gjithsej 8 (tetë) anëtarë të gatshëm për gjykim si pjesë përbërëse të këtij komisioni, bazuar në kriteret e parashikuara në Nenin 8 të kësaj rregullore.
2. Përveç anëtarëve të mësipërm, pjesë përbërse e Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor Profesional zgjidhet një prej juristëve të Zyrës Juridike të administratës së Urdhrit të Psikologut.

Neni 8

Kriteret e përzgjedhjes për anëtarët psikologë

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Kandidaturat për anëtarë të Komisionit të Gjykimit Disiplinor Profesional duhet të plotësojnë

këto kritere:

- a. Të kenë përvojë jo më pak se 10 vjet në ushtrimin e profesionit;
 - b. Të mos jenë ndëshkuar me masë disiplinore në pesë vitet e fundit;
 - c. Të mos jenë të dënuar nga organet e drejtësisë;
 - d. Të mos kenë lidhje të afërt gjinore apo krushqie me ndonjë anëtar të Këshillit Kombëtar;
2. Cilësia e anëtarit të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional është e papajtueshme me çdo lloj funksioni drejtues në administratën e institucioneve shtetërore.

Neni 9

Kohëzgjatja e mandatit të anëtarit të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional

Mandati i anëtarit të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional është 3 (tre) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Neni 10

Lirimi i parakohshëm nga detyra i anëtarit të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Lirimi i parakohshëm nga detyra e anëtarit të Komisionit bëhet kur:
- a. paraqet kërkesë me shkrim për dorëheqje;
 - b. dënohet me vendim të formës së prerë për vepra penale ose shkelje disiplinore;
 - c. mungon tre herë të njëpasnjëshme në seancat e gjyimit profesional;
 - d. bëhet i paaftë për arsye shëndetësore;
- a. nëpërmjet veprimeve dhe/ose mosveprimeve bëhet pengesë për mbarëvajtjen e punës së Komisionit
- b. në çdo rast kur sjellja apo qëndrimet e tij çenojnë imazhin e institucionit
2. Largimi i parakohshëm dhe zëvendësimi bëhet me propozim të çdo anëtari tjetër të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional, çdo anëtar të Këshillit Kombëtar ose të Presidentit, dhe bëhet

efektiv pas marrjes së vendimit nga Këshilli Kombëtar.

Neni 11

Ndalimi për pjesëmarrje në komisionet disiplinore

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

- 1.Nuk mund të marrë pjesë në Gjykimin Disiplinor Profesional, anëtari që ka lidhje gjinie, të afërt apo të largët, apo çfarëdo lidhje tjetër interesi me personat në gjykim.
- 2.Në rastet kur kërkohet nga palët përjashtimi i një anëtari të Komisionit nga gjykimi dhe ky i fundit çmon se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, vendimi për ndalimin ose jo të pjesëmarrjes në gjykim merret me shumicë të thjeshtë votash nga anëtarët e tjerë të Komisionit. Nëse votat janë të barabarta, kërkesa konsiderohet e pranuar.
- 3.Në rast të pranimit të kërkesës, gjykimi vijon nga anëtarët e mbetur të komisionit.
- 4.E njëjta procedurë zbatohet në të njëjtat raste edhe në gjykimin në shkallë të dytë.

Neni 12

Masat disiplinore

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Kur sipas fakteve dhe provave të administruara në dosjen e çështjes, vërtetohet se anëtari ka kryer sjellje apo veprime, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit, dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë, ligjit apo statutit të UP-së, Komisioni Disiplinor jep këto masa disiplinore:
 - a. vërejtje me shkrim,
 - b. vërejtje me paralajmërim për heqjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit,

- c. gjobë nga 10.000 (dhjetë mijë) lekë deri në 100.000 (njëqindmijë) lekë.
 - d. propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucionet shëndetësore dhe private;
 - e. pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut deri në 3 vjet;
 - f. përjashtim nga Urdhëri i Psikologut për një periudhë deri në 3 vjet;
2. Masat disiplinore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni shlyhen në qoftë se ndaj anëtarit nuk është marrë ndonjë masë tjetër disiplinore si vijon:
- a. brenda një viti nga data e dhënies së tyre, për shkronjat “a” dhe “b” të pikës “1” të këtij neni;
 - b. brenda tre vitesh nga dita e dhënies së tyre, për shkronjat “d”, “e” dhe “f” të pikës “1” të këtij neni;
3. Gjoha e vendosur sipas shkronjës “c” të pikës “1” të këtij neni derdhet në buxhetin e shtetit.
4. Nuk mund të jepet më shumë se një masë për një shkelje të konstatuar.

PJESA E TRETË

PROCESI I GJYKIMIT DISIPLINOR

Neni 13

Gjykimi në Komisionin Etik Disiplinor Profesional

(Ndryshuar me vendimin nr.4, datë 02.06.2023 të Asamblesë VII-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

Për çdo ankesë të mbërritur në Komision fillohet procesi disiplinor sipas kësaj procedure:

1. Zyra Juridike, pasi verifikon kushtet formale të pranueshmërisë, regjistron ankesën në Regjistrin e Ankesave, dhe ia paraqet Sekretari të Përgjithshëm.
2. Përzgjedhja e trupës së gjyimit të Komisionit të Etikës dhe Gjyimit Disiplinor prej 5 anëtarësh përpara çdo çështje do të realizohet si më poshtë:
 - a) Relatori i çështjes përcaktohet me rotacion, sipas një rradhe të paracaktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit të Psikologut, një nga anëtarët e zgjedhur të Komisionit sipas nenit 7.1 të kësaj rregullore.

b) Një anëtar është në çdo rast juristi i Zyrës Juridike pranë Urdhrit të Psikologut, i përcaktuar sipas nenit 7.2 të kësaj rregullore.

c) Tre anëtarët e tjerë përzgjidhen nëpërmjet një shorti të hapur, i cili realizohet nën mbikqyrjen e Sekretari të Përgjithshëm të Urdhrit të Psikologut.

d) Në rastet e dorëheqjes apo të miratimit të kërkesës për përjashtimin e një apo më shumë anëtarëve pjesë e trupës së gjykimit, anëtari apo anëtarët e larguar zëvendësohen nga anëtarë të tjerë të gatshëm, sipas procedurës së përcaktuar në pikën c) të këtij neni, duke vijuar gjykimin e çështjes me pesë anëtarë.

3. Anëtari i Komisionit i zgjedhur nga Zyra Juridike është përgjegjës për ndjekjen e procedurave administrative në lidhje me njoftimin e palëve dhe respektimin e afateve të gjykimit disiplinor. Ai njofton zyrtarisht psikologun e paditur për ankesën e ardhur kundër tij, duke e njohur me:

a. përmbajtjen e ankesës;

b. detyrimin që brenda 10 ditëve të paraqesë me shkrim qëndrimin e tij dhe provat në favor të tij të cilat kërkon që të administrohen në gjykim;

c. të drejtën për tu përfaqësuar në gjykimin disiplinor kundër tij nga një avokat;

d. detyrimin për të qenë i pranishëm në seancën dëgjimore, nëse Komisioni do të çmojë të domosdoshme praninë e tij.

4. Anëtari i Komisionit i zgjedhur nga Zyra Juridike ka të drejtë t'i kërkojë palës ankuese çdo informacion plotësues lidhur me pretendimet e ngritura në ankesë dhe kërkon nga pala ankuese që të paraqesë çdo provë që e ajo çmon të arsyeshme për vërtetimin e këtyre pretendimeve. Pala ankuese njihet gjithashtu me të drejtën për t'u përfaqësuar e mbrojtur nga një avokat i licencuar dhe detyrimin për të qenë prezent në seancën dëgjimore nëse komisioni i gjykimit e çmon si të domosdoshme një gjë të tillë.

5. Pasi ka mbledhur të gjithë pretendimet e palëve, Anëtari i Komisionit i zgjedhur nga Zyra Juridike ia përcjellë ato Relatorit të çështjes.

6. Relatori i çështjes ka të drejtë të kërkojë nga palët çdo dokument apo provë tjetër shtesë që e gjykon të nevojshme, si dhe ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë çdo institucioni publik apo privat, për të marrë çdo të dhënë, që e konsideron të nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

7. Pasi ka mbledhur të gjithë pretendimet shtesë të palëve, relatori harton një Raport mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes, dhe ia përcjellë Anëtarit të Komisionit të zgjedhur nga Zyra Juridike, i cili pasi ua përcjell anëtarëve të tjerë të Komisionit, cakton, jo më larg se brenda 10

ditëve, datën e seancës dëgjimore.

Neni 14

Procedurat paraprake për Gjykimin në Komisionin Etik Disiplinor Profesional

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Seanca dëgjimore bëhet me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve efektivë të Komisionit.
2. Proçesi disiplinor i gjykimit drejtohet nga relatori i çështjes.
3. Anëtarët e Komisionit Disiplinor lajmërohen nga anëtari i Komisionit i zgjedhur nga Zyra Juridike për datën dhe orën e seancës dëgjimore dhe çështjen, që do të gjykohet, jo më vonë se 5 (pesë) ditë, para datës së caktuar për seancën dëgjimore, me çdo mjet komunikimi nëpërmjet të cilit konfirmohet marrja e njoftimit.
4. Pasi dëgjon palët dhe njihet me provat, Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional, nëse e çmon të nevojshme, mund të vendosë marrjen e provave të tjera dhe të shtyjë seancën dëgjimore.
5. Gjykimi Disiplinor duhet të përfundojë jo më vonë se 60 ditë nga dita e dorëzimit të ankesës. Mos përfundimi i gjykimit brenda këtij afati nuk e bën vendimin e marrë të pavlefshëm, por është shkak për përjashtimin nga Komisioni Disiplinor i anëtarëve që e kanë shkaktuar atë.
6. Gjykimi Disiplinor Profesional zhvillohet në 2 (dy) faza:
 - a. faza e hapur (seanca dëgjimore);
 - b. faza e mbyllur dhe vendimarrja.

Neni 15

Mungesa e pjesëmarrjes së palëve në gjykimin disiplinor profesional

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Palët në gjykim njoftohen nga anëtari i Komisionit i zgjedhur nga Zyra Juridike në adresën e deklaruar në ankesë apo në regjistrin e Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.
2. Gjatë gjykimit disiplinor profesional, nëse njëra nga palët mungon personalisht dhe nuk përfaqësohet në seancën dëgjimore nga personi i autorizuar për arsye të justifikuara, seanca shtyhet duke u caktuar një datë tjetër, e cila u komunikohet palëve.
3. Gjatë Gjykimit Disiplinor Profesional, mungesa e pajustificuar e palëve ndërgjyqëse sjell si pasojë gjykimin në mungesë të tyre.

Neni 16

Pjesëmarrja në seancë dhe komunikimi me median

1. Për pjesëmarrjen e të ftuarve dhe të publikut në seancat e gjykimit disiplinor profesional, vendoset për çdo rast në mënyrë të veçantë nga Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional përkatës, duke marrë parasysh ruajtjen dhe moscënimin e privatësisë për të gjitha palët e përfshira.
2. Ndalohet dhënia e informacionit për mediat para së të shpallet vendimi përfundimtar nga Këshilli Kombëtar.

Neni 17

Faza e hapur e gjykimit

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1. Në seancën dëgjimore një punonjës i administratës së Urdhrit të Psikologut, i caktuar nga Presidenti, mban procesverbalin, ku shënon pjesëmarrjen e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë në seancë, si dhe mban në mënyrë të përmblodhur të dhënat e seancës dëgjimore. Seanca dëgjimore mund të regjistrohet në audio.

- 2.Seancën e drejton relatori, i cili lexon Raportin mbi Verifikimin Paraprak të Çështjes.
- 3.I jepet fjala palës që ka paraqitur ankimin për të paraqitur edhe një herë ankesën e saj, si dhe nëse ka për të paraqitur, apo dorëzuar prova të tjera në lidhje me çështjen, pastaj i jepet fjala palës së paditur, për të paraqitur prapësimet e saj në lidhje me ankesën, si dhe nëse ka për të paraqitur, apo dorëzuar prova të tjera në lidhje me çështjen. Në raste përjashtimore, Komisioni mund të vendosë që palët të dëgjoen veç e veç, nëse i shërben mbarëvajtjes së procesit.
- 4.Relatori i çështjes, pasi dëgjon palët, nëse e sheh të nevojshme, kërkon detajime të mëtejshme nga palët ndërgjyqëse, si dhe në rast se e vlerëson të rastit, bën përpjekje për zgjidhjen me mirëkuptim të ankesës së paraqitur.
- 5.Më pas u jepet fjala ekspertëve, në rast se janë thirrur të tillë.
- 6.Relatori u kërkon anëtarëve të Komisionit nëse kanë pyetje për palët në gjykim, si dhe për ekspertët.
- 7.Nëse gjatë seancës lindin kërkesa për verifikime plotësuese, Komisioni vendos ndërprerjen e seancës, duke e pasqyruar këtë në procesverbal, i cili firmoset nga anëtarët e komisionit. Seanca tjetër detyrimisht zhvillohet brenda limitit kohor 60 ditë nga data e depozitimit të ankesës me shkrim në Komision.
- 8.Para mbylljes së seancës, u jepet fjala palëve në gjykim, në fillim asaj ankuese, pastaj palës tjetër, nëse kanë shpjegime të tjera.
- 9.Në përfundim, relatori u komunikon palëve kalimin e çështjes në fazën e dytë (faza e mbyllur dhe vendimmarrja).
- 10.Në asnjë rast dokumentacioni i depozituar në dosje nuk mund të nxirret jashtë ambienteve të Urdhrit, të fotokopjohet, të riprodhohet apo të bëhet publik nga anëtarët e Komisionit.

Neni 18

Faza e mbyllur dhe vendimmarrja

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 28.02.2020 të Asamblesë IV Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

- 1.Faza e mbyllur dhe vendim marrja realizohet menjëherë pas seancës dëgjimore, pa praninë e

pjesëmarrësve në proces.

2.Relatori u kërkon anëtarëve të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional të shprehin mendimin dhe të argumentojnë atë, për marrjen apo jo të masës ndëshkuese ndaj psikologut të paditur.

3.Pasi merr në konsideratë mendimet e anëtarëve të Komisionit të Gjyimit Disiplinor Profesional, relatori paraqet propozimin e tij, i cili hidhet në votim të hapur kundrejt propozimeve të tjera alternative. Nuk lejohet abstenimi. Mbetet në fuqi propozimi, që ka shumicën e thjeshtë të votave. Në rastet përjashtimore, kur numri i votave është i barabartë, vota e relatorit është përcaktuese. Marrja e vendimit nuk mund të shtyhet. Dispozitivi i shkruar nënshkruhet nga të gjithë anëtarët. Anëtarët që kanë votuar kundër ose kanë mendim paralel nënshkruajnë me shënimin përkatës. Dispozitivi depozitohet në sekretarinë e Urdhrit dhe regjistrohet në regjistrin përkatës.

4.Relatori, duke u mbështetur në procesverbalin dhe në vendimin e marrë nga Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional, e zbardh brenda 5 ditëve vendimin në 3 (tre) kopje, të cilin e firmosin Anëtarët e Komisionit Disiplinor Profesional dhe depozitohet në Zyrën Juridike të Urdhrit.

5.Vendimi i zbardhur, së bashku me shkresën përcjellëse të nënshkruar nga Presidenti i Urdhrit, u dorëzohet palëve ndërgjyqëse nga Zyra Juridike, duke u komunikuar atyre se kundrejt këtij vendimi, brenda 15 ditëve kalendarike, mund të bëhet ankimim në Këshillin Kombëtar. Një kopje e vendimit mbahet në sekretarinë e Urdhrit dhe nga një kopje u dorëzohet palëve ndërgjyqëse.

Neni 19

Ankimi

(Ndryshuar me vendimin nr.1, datë 18.06.2021 të Asamblesë V-të Kombëtare të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë)

1.Ankimet kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore nga Komisioni Etik Disiplinor Profesional, i paraqiten Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut brenda 15 ditëve nga data e komunikimit me shkrim të vendimit të Komisionit Etik Disiplinor Profesional.

2. Nuk mund të ushtrohet e drejta e ankimit nga pala ankuese në rastet kur nuk është marrë masë

disiplinore nga ana e Komisionit Etik dhe Gjykimit Disiplinor Profesional. Në rast të depozitimit të ankesës është Zyra Jurike e Urdhrit të Psikologut e cila e informon palën ankuese, duke e sqaruar për pamundësinë e shqyrtimit nga ana e Këshillit Kombëtar të ankesës, pa qenë e nevojshme mbledhja e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.

3. Presidenti i Urdhrit të Psikologut thërret brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës, mbledhjen e Këshillit Kombëtar për të marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur.

4. Presidenti i relaton Këshillit Kombëtar thelbin e ankesës dhe hedh në votim nëse Këshilli Kombëtar do të marr një vendim brenda mbledhjes së thirrur për ankesën e paraqitur apo do të ngrejë një komision *ad-hoc*.

5. Në rastin kur Këshilli Kombëtar vendos të ngrejë një Komision *ad-hoc* për shqyrtimin e çështjes, ky komision përbëhet nga tre anëtarë të tij, të cilët zgjidhen me votim të hapur dhe të thjeshtë. Komisioni brenda 7 ditësh duhet të paraqesë pranë Zyrës Juridike një relacion, i cili duhet të përmbajë edhe rekomandimet që komisioni *ad-hoc* i paraqet Këshillit Kombëtar në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Presidenti i Urdhrit të Psikologut, thërret brenda 30 ditëve mbledhjen e Këshillit Kombëtar për shqyrtimin e relacionit dhe marrjen e një vendimi përfundimtar. Rekomandimet e komisionit *ad-hoc* nuk janë detyruese për Këshillin Kombëtar.

6. Këshillit Kombëtar merr përfundimisht këto vendime:

- a) Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit Etik Disiplinor Profesional;
- b) Ndryshimin e vendimit dhe zgjidhjen e çështjes në themel.

7. Vendimi i Këshillit Kombëtar ankimohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas legjislacionit në fuqi.

PJESA E KATËRT

Dispozita përfundimtare

Neni 20

Njoftim i institucioneve për vendimet e gjykimit disiplinor profesional

1. Vendimi i Gjykimit Disiplinor Profesional, i bëhet i ditur institucionit, në të cilin psikologu ushtron profesionin.
2. Vendimi i Gjykimit Disiplinor Profesional, me të cilin merret masë disiplinore ndaj psikologut, në raste me interes të veçantë, i bëhet i ditur Ministrisë përkatëse.

Neni 21

Shpërblimi i pjesëmarrjes në proceset disiplinore

1. Anëtarët e Komisionit të Gjykimi Disiplinor Profesional shpërblehen me honorare nga U.P.-ja, sipas mënyrës dhe tarifave të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.

Neni 22

Hyrja ne fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Asambleja Kombëtare e Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.

Miratuar me vendimin nr.1, datë 30.06.2017 të Asamblesë Kombëtare të Urdhrit të Psikologut të Republikës së Shqipërisë.

